



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.3.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e punës së Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ERRU për vitin 2021” (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Fatjon Veizaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Pranvera Resulaj.

Mungojnë:

Tatiana Piro, Anduel Tahiraj, Rrahman Rraja, Alqi Bllako, Flamur Hoxha dhe Ramadan Likaj.

Të ftuar:

S’ka.

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2021”

Relator është zoti Laert Durraj. Vazhdojmë me leximin e tekstit të projektrezolutës dhe pastaj nëse kenë për të shtuar ndonjë gjë.

Laert Durraj – Përshëndetje!

Po paraqes këtë projektrezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për vitin 2021”

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

Duke theksuar treguesit kryesorë të performancës për vitin 2021 në sektorin Ujësjetellës-Kanalizimeve paraqiten me një përmirësim të lehtë pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesve për mbulimin e kostove O&M dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë, të cilët mbesin në të njëjtin nivel me ato të vitit 2020;

Duke mbajtur parasysh se ky përmirësim i treguesve vjen pas përkeqësimit që treguesit patën gjatë pandemisë së Covid-19 dhe tërmetit të fundvitit 2019;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disavjeçare që diskutohen ende nuk janë realizuar, si dhe duke nxitur qeverinë dhe gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një impakt pozitiv si në sektorin e Ujësjetellës – Kanalizimeve, ashtu edhe në lidhje me pavarësinë institucionale dhe operacionale të ERRU-së, rolit të saj në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit;

Duke theksuar nevojën e përmirësimit të aspekteve të menaxhimit nga shoqëritë e Ujësjetellës-Kanalizimeve, për t’i bërë ato më të qëndrueshme financiarisht, si dhe për të rritur transparencën e tyre me konsumatorët.

Vlerëson për vitin 2021:

Përmirësim e lehtë e pothuajse të të gjithë treguesve kryesorë të performancës për vitin 2021 me përjashtim të treguesve për mbulimin e kostove O&M dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë, të cilët mbetën në të njëjtin nivel me një vit më parë;

Krijimin e një praktike standarde monitorimi për shoqëritë e Ujësjetës-Kanalizimeve me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit duke hartuar një program vjetor për monitorimin e shoqërive të Ujësjetës-Kanalizimeve për trajtimin e ankesave të konsumatorit, ku tashmë, për të nxitur shoqëritë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorit, përgjigjet ndaj “Ankesave të klientëve” dhe “Zgjidhjet e ankesave të klientëve”, do të ndikojnë në përditësimin tarifor përmes dhënies së bonusit/penalitetit;

Miratimin e rregullores për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (ZAM) midis konsumatorit dhe operatorit ujësjetës-kanalizime nga struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes, si një mundësi më shumë, si dhe një përmirësim të procedurave dhe efikasitetit të zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve;

Punën e bërë nga ERRU për zgjidhjen e problematikave në drejtim të mbi faturimit të konsumatorëve familjarë kur ato nuk janë të pajisur me matës dhe faturohen aforfe mbi normën e konsumit prej 150 litra/ditë/person (4.5 m³/muaj/person);

Përpjekjet për të bërë të mundur promovimin e institucionit, përmes dëgjësive publike, si dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe në rritjen e besimit të konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre;

Rishikimin e metodologjisë tarifore përmes miratimit të dokumentit “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetës kanalizimeve”, metodologjia e rishikuar përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-plus” e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M, dhe ajo e “Çmimit tavan”, e cila kërkon që shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja detyruesisht bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar dhe aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri 100% të kostove kapitale të aktivitetit;

Studimin e bërë nga ERRU-ja lidhur me problematikën e mbulimit të kostove të energjisë për shoqëritë e Ujësjetës-Kanalizimeve, si një problematikë e mbartur në vite dhe tepër e rëndësishme për t’u zgjidhur, studimi ka për qëllim paraqitjen e gjendjes së shoqërive të

Ujësjellës-Kanalizimeve me nivel debie të lartë ndaj (OSHEE), analiza e faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënia e rekomandimeve për mundësinë e shlyerjes së tyre.

Rekomandon për vitin 2022:

1. ERRU-ja, në bashkëpunim edhe me Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime (AKUM), si dhe me aktorët e tjerë në sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve, duhet të bashkërendojë punën për të gjetur zgjidhje konkrete dhe mekanizmat e duhur për të vënë në pozita pune ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe përmirësimin e performancës në sektor e veçanërisht të ujit pa të ardhura. Grandet apo financimet që jepen për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve duhet të kushtëzohen me arritjen e objektivave të vëna nga ERRU-ja dhe rritjen e performancës. Është e paparanueshme që me gjithë që nga njëra anë investimet e qeverisë në sektorin e UK rriten, dhe nga ana tjetër humbjet (Uji pa të ardhura) për vite me radhë vijojnë të mbeten në nivele tepër të larta, kjo tregon se ka keqmenaxhim të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve;

2. ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret në kuadër të nismës së qeverisë qendrore, të ndërmarrë gjatë vitit 2021, mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare;

3. ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve), AMBU (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore), si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për të bërë të mundur përmirësimin rrënjësor të performancës së sektorit UK;

4. ERRU-ja në monitorimet e shoqërive UK në terren të kontrollojë me rigorozitet profilin e punonjësve të ndërmarrjeve UK në mënyrë që të përputhet me pozicionin e tyre të punës, si edhe të mbajë parasysh faktin që shoqëritë UK në jo pak raste janë të mbingarkuara me staf të punësuar jashtë nevojave reale dhe të stimuluar nga politika, politika duhet të nxjerrë duart nga punësimet në ujësjellës;

5. ERRU-ja të rekomandojë rishikimin e legjislacionit për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë të ujësjellësve (monitorimin në distancë të objekteve me kamera) për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të stafit dhe uljen e numrit të punonjësve. Shërbimi me personel roje fizike i sigurisë së objekteve të ujësjellësve ka ndikim negativ në

treguesin e eficiencës së stafit, (treguesi i eficiencës së stafit pa përfshirë shërbimin roje do të ishte në nivelin e 4.9 punonjës për 1000 lidhje nga 5.28 punonjës për 1000 lidhje për shkak të punonjësve të sigurisë për ruajtjen e objekteve të ujësjellësve);

6. ERRU-ja të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive të Ujësjiellës-Kanalizimeve mbi mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe evidentimit të problematikave që kanë shoqëritë në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime konkrete për tu realizuar nga ato;

7. ERRU-ja të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e ligjit nr. 8102 për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur në funksion të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi si dhe për riaktivizimin e grupit të punës për të bërë të mundur ndryshimin e nevojshme ligjore për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive të Ujësjiellës-Kanalizimeve për plotësimin e kushteve të aktmiratimit të lejes higjieno – sanitare;

8. ERRU-ja në ristrukturimin e faqes zyrtare në internet të bëjë të mundur që faqja e re të jetë më pranë, konsumatorit, më e lehtë në përdorim dhe ku konsumatorët të kenë akses për komente, ankesa dhe pjesëmarrje në problematikën e ndryshme të shërbimeve të Ujësjiellës Kanalizimeve që ofrohen nga shoqëritë e Ujësjiellës-Kanalizimeve;

9. ERRU-ja në vijim të studimit të bërë nga ana e saj lidhur me problematikën e mbulimit të kostove të energjisë për shoqëritë e Ujësjiellës-Kanalizimeve të iniciojë një bashkëpunim AKUM-ERRU-OSHEE për të kryer një analizë e thelluar e gjendjes për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike sipas një vlerësimi real të treguesve kryesorë të performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të këtyre shoqërive.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

A keni ndonjë mendim, diskutim, apo ndonjë shtesë?

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj –Edhe kur është diskutuar herën e parë ishte një diskutim shterues, por megjithatë shoh se disa gjëra nuk janë pasqyruar në këtë rezolutë përmbledhëse:

Së pari, nuk është trajtuar çështja për eliminimin e humbjeve që në burim për shkak të defekteve dhe amortizimit të rrjetit të shpërndarjes dhe për shkak të ndërhyrjeve nga faktorë të

tjerë subjektivë që ujin e pijshëm e përdorin edhe për qëllime të tjera. Gjithashtu, Enti Rregullator i Ujit duhet ta kishte si rekomandim eliminimin drejt zeros të kontratave aforfe, sepse janë burim i shpenzimit të pakontrolluar për shkak të kontratës aforfe, madje konsumatorët e përdorin ujin edhe për kopshtin edhe për stallën e bagëtive.

Nga ana tjetër nuk është pasqyruar edhe një shqetësim tjetër që ka të bëjë me sigurinë higjieno-sanitare dhe ruajtjen me masa të rrepta, por sidomos me sigurinë higjieno-sanitare të depove grumbulluese dhe të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

Lidhur me pikat e tjera që rekomandohen ne nuk mund të kemi një matës real sa është e ngarkuar politikisht një ndërmarrje ujësjellësi, sepse e pranojmë se njerëzit janë ose politikë, ose apolitikë, por nuk duhet të nxjerrim një përfundim sipas të cilit shkak i mbingarkesës janë punonjësit jashtë nevojave reale dhe të stimuluar nga politika e të tjera. Ata që do të punësohen mund të jenë njerëz që merren me politikë, por ne nuk kemi një matës studimor real dhe më vjen keq që Enti Rregullator e shprehu edhe herën e parë, por punonjësit mund të jenë politikë, por janë specialistë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse e tha drejtori, nuk tha ndonjë gjë të madhe, nuk shpiku rrotën. Le të jenë politikë ose jo politikë, mjafton të jetë specialist, mbi bazën e performancës ose profesionit jam plotësisht dakord që t'i monitorojmë, siç e ka rregullorja, por kjo nuk vlen, aq më keq ta miratojmë, sepse më duket si ndonjë rekomandim politik. Unë nuk jam dakord me këtë pikë.

Gjithashtu, një propozim tjetër që bëra është i lidhur me performancën e ndërmarrjeve, të performancës të vlerësimit të një ndërmarrjeje, se sa punon nuk është marrë në konsideratë numri i banorëve. Realisht ne nga zonat e thella rurale kemi një lëvizje demografike drejt qyteteve dhe qytet që janë të urbanizuara si Tirana, Durrësi, Korça e të tjera. Marr një rast konkret të Mallakastrës, fillon në Lushnjë dhe mbaron në Tepelenë, fillon në Berat dhe kufirin tjetër e ka në Vlorë, se nuk po e quaj pjesën Bashkisë së Fierit. Po të mbledhësh sa kilometra infrastrukturë janë dhe sa njerëz duhet të monitorohet, nuk është futur, ndaj unë propozoj që një nga pikat e kësaj rezolute të jetë rishikimi i treguesve të performancës dhe të futet edhe shtrirja gjeografike, sepse edhe një qytetar të kemi atje në malin më të largët në kufi me Tepelenën në Gllavë ne duhet t'ia çojmë ujin.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi- Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Duke parë rezolutën shoh se ka përsëri çështje që mund të gjejnë vend në këtë rezolutë, së pari, autoriteti kryesor i vendosjes së çmimit është ERRU-ja, që do të thotë se çmimi vendoset mbi bazën e kostos, dhe nuk besoj se është ndonjë ndërmarrje private që do të nxjerrë fitim. Pra, vendosja e çmimit duhet t'i përmbahet ligjit që çmimi vendoset mbi bazën e kostos. Nuk ka qenë në referencë kostoja, edhe në komunikimin që pata me drejtuesin e ERRU-së i thashë se ka raste që çmimi është me dy herë ose më shumë në disa ujësjellës në raport me koston.

Së dyti, është prekur niveli i lartë i të punësuarve për një mijë lidhje që shkon nga 5,5-5,6. Është vërtetë absurde që kur është modernizuar në raport me të kaluarën në vend që të vijë duke u ulur numri i të punësuarve ka ardhur duke u rritur. Unë do të dëshiroja që niveli i personave për një mijë lidhje të jetë edhe më pak se është në rezolutë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të ulen kostot dhe për pasojë do të ndikojë në uljen e çmimit të ujit dhe do të kemi një performancë ende më të mirë të ndërmarrjes.

Tjetër problem që u ngrit dhe duhet të shihet është se kemi disa ujësjellës sot në Shqipëri ujësjellësi i Korçës konsiderohet si ujësjellësi më i mirë në Shqipëri. Po është edhe Lezha dhe e paguan vetë. Kurse Korça që ka 15 vjet që e mban këtë flamur, ka marrë kredi edhe për ujërat e zeza edhe për ujin e pijshëm dhe madje ka një automatizim maksimal dhe asnjë qindarkë nuk paguhet nga kjo ndërmarrje, por paguhet edhe nga banorët e Tiranës, Dibrës ose dikush tjetër pra paguhet nga paratë e buxhetit të shtetit. Në këtë kontekst patjetër Enti Rregullator i Ujësjellësit është autoriteti kryesor dhe ka rolin e saj edhe qeveria, por duhet që ata të paguajnë këtë kredi, siç është Korça, por edhe ujësjellës të tjerë që kanë kredi shtetërore ose marrin kredi nga shteti.

Tjetër problem që tregon që nuk ka barazi, janë debitë. Kemi ujësjellësin, siç është ai i Durrësit, por janë edhe ujësjellës të tjerë, të cilët paguajnë dhe kanë debitor me rreth 50 milionë euro. Po si ka mundësi të mos paguash energjinë elektrike e cila ndikon në rritjen e çmimit të energjisë elektrike në rang vendi, por edhe pabarazinë që krijohet mes ujësjellësve. Pra, duhet që Enti Rregullator të detyrojë çdo ujësjellës që debinë që ka ta paguajë dhe të konvertohet pastaj edhe në kosto që të mos kemi diferenca në mes klientëve.

Tjetër problem ishte tjetërsimi i rolit të bashkive tek ujësjellësit. Bashkia është aktori kryesor në mendimin tim në marrëdhënie me ujësjellësin dhe po prapë flitet për normalizim dhe ekonomi shkalle. Nuk e kemi atë luks ne që të kemi rajonalizim dhe ekonomi shkalle kur kemi

një bashki ose një komunitet që furnizohet 24 në 7 ditë dhe kemi një bashki që furnizohet zero-në një orë deri në 24, pra në 7 ditë 6-7 orë. Kjo është absurde. Ekonomia e shkallës do ta thellojë diferencën e furnizimit me ujë. Pra, duhet të krijohen standardet ekstensive midis këtyre zonave dhe pastaj të zbatohet rajonizimi ose ekonomia e shkallës.

Tjetër problem është vazhdimi i humbjeve. Ka zona që kanë furnizim me 16024 orë, është e papranueshme të ketë një humbje të madhe sa e tregojnë shifrat. Pavarësisht shifrave që kemi, ku thuhet se furnizohen 24 orë, në fakt, ata nuk furnizohen as ¼-ta e 24 orëve, siç ishte rasti që ju tregova herën e kaluar.

Unë do të dëshiroja që në këtë projektrezolutë të gjenin vend edhe këto shqetësime që unë thashë. Pastaj përtej kësaj unë kam një shqetësim shumë të madh, ne kur kemi qenë unë zoti Nasufi dhe Baftjari, bëhej projekti duke iu referua buletinit koherent të çmimeve dhe sot po të shohësh sidomos në këtë një vit e gjysmë tek AKU-ja jepen tendera me çmime 5 herë më shumë sesa ishin më parë. Pra, një kompani bën një projekt, e dërgon te bashkia dhe pastaj bëhet zbatimi i saj. Nëse shohim çmimet e këtyre projekteve, referuar edhe projekteve të mëparshme apo projekteve që bën Autoriteti i Ujësjellës-Kanalizimeve, ka një diferencë të theksuar.

Pra, roli i AKU-së është vërtet i jashtëzakonshëm edhe në këtë drejtim, për të mos pasur diferenca kaq të mëdha midis kostos që ka referencë buletini, që bëhet nga specialistë të drejtorive përkatëse, nga ato që bëjnë ndërmarrjet, duke moskërkuar pagesën për projektin, por e marrin me 5 apo 10 herë më shumë te zbatimi i atij projekti.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Pa diskutim që do të flasim të gjithë, por do të doja të përqendrohemi tek objekti që kemi sot. Këto diskutime i kemi bërë edhe kur patëm këtu përfaqësuesit e ERRU-së, të cilët dhanë edhe përgjigje, edhe shpjegime. E para.

E dyta, duhet të kemi të qartë që ERRU-ja vepron në bazë të një legjislacioni të caktuar dhe kompetencat e saj nuk i mbivendosen as AKU-së dhe as institucioneve të tjera. ERRU-ja thjesht monitoron shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve dhe është kompetente për analizimin e çmimeve dhe ankesave që vijnë nga qytetarët.

Tjetra, ne vit për vit nxjerrim rezoluta dhe sugjerime, sepse ERRU-ja është një institucion i pavarur në punën e saj dhe operon në bazë të legjislacionit, por meqenëse ka varësi nga

Kuvendi dhe nga ky komision, ne i sugjerojmë se cilat janë disa prej pikave që ajo duhet të marrë parasysh gjatë vitit që vjen.

Disa nga shqetësimet që kolegët ngritën kanë qenë pjesë e rezolutës që Kuvendi i ka ngarkuar si detyra ERRU-së ndër vite, dhe mendohet që përsëritja e vazhdueshme e këtyre gjërave nuk i shërben punës së ERRU-së, por në pjesë e mirë e tyre janë adresuar si shqetësime. Kështu që, pavarësisht faktit që unë ju mirëkuptoj të gjithëve dhe të gjithë e kemi këtë shqetësim në lidhje me furnizimin me ujë nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo çështjet e tenderave, këto nuk janë pjesë as e ERRU-së dhe as e kësaj rezolute. Kështu që, të jemi pak më racionalë në diskutime. Pastaj, nëse një koleg realisht dëshiron të bëjë një ndryshim në këtë rezolutë, duhet ta formulojë siç duhet, sepse në fund fare ne do ta vendosim me votë qoftë këtë, qoftë çdolloj ndryshimi që mund t'i bëjmë kësaj rezolute.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Nusret Avdulla – Në takimin e parë unë ngrita disa pyetje dhe do të kisha dashur të ishin përfshirë të paktën si opsione te kjo projektrezolutë.

E para, është borxhi i akumuluar ndër vite që kanë të gjitha shoqëritë e ujësjellësve për shkak të faturave fiktive.

E dyta, është borxhi që kanë për energjinë elektrike.

E treta, është puna e ujësjellës-kanalizimeve, që vetëm emrin kanë atje, por unë nuk shikoj asnjë opion për të dhënë një mendim apo sugjerim që këto ndërmarrje të ujësjellës-kanalizimeve, në aspektin e kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura e të tjera, nuk shoh asgjë. Do të ishte pozitive në qoftë se do të jepnim një opion, nuk them se do të jepnim zgjidhje. Këto fatura mbarten çdo vit dhe për këtë duhej gjetur një zgjidhje ose të jepej një opion, të falen, për shembull. Ky borxhi që kanë nga energjia elektrike të gjithë ujësjellësit, do të vazhdojë vit pas viti?

Kështu që, mendoj se do të ishte më e drejtë të jepnit një opion se si do të gjente zgjidhje ky problem.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi –Ne i rekomandojmë ERRU-së, nëse ajo e merr parasysh ose jo, është në të drejtën e saj mënyra se si operon ajo në bazë të ligjit përkatës që ka. Ne rekomandojmë shqetësimet që na vijnë nga banorët dhe nga jeta jonë e përditshme dhe nga diskutimi që bëjmë

me përfaqësuesit e ERRU-së, duke qenë se kanë varësi nga Kuvendi. Por ne as u imponohemi dot në këtë aspekt dhe as nuk mund të rekomandojmë gjëra, të cilat mund të jenë jashtë nomenklaturës së punës së tyre. Pra, ajo që është e ndërmarrjes së ujësjellësve, është e tyre, edhe ERRU-ja nuk u kërkon dot llogari ujësjellës-kanalizimeve për çdo gjë, sikurse nga krahu tjetër, ERRU-ja nuk ka asnjë lloj tagri në lidhje me investimet që bëhen në ujësjellës-kanalizime. Pra, duke pasur parasysh faktin që ERRU-ja do të vendosë çmimet, në qoftë se një ndërmarrje e ujësjellës-kanalizimeve do të bëjë ndryshim të çmimeve, do të shkojë në ERRU ta japë këtë çmim dhe do të justifikojë kostot.

Pikërisht, duke justifikuar kostot, ne rekomandojmë për numrin e punonjësve apo gjëra të ndryshme që kanë të bëjnë me punën e ERRU-së. ERRU-ja merret me kostot e ujësjellës-kanalizimeve dhe duhet të ketë një rol aktiv në agregim, por agregimin nuk e bën ajo, por është politikë qeveritare. Në rast se qeveria do të vendosë ta kalojë pronësinë nga pushteti lokal, përsëri te pushteti qendror, këtë gjë nuk e ka në dorë ERRU-ja dhe këtë nuk ua themi dot as ne, kjo do të bëhet me ligj të veçantë ku ne pastaj do të diskutojmë dhe do t'i rekomandojmë ERRU-së atë që ajo ka mundësi të bëjë. Kaq është e gjitha.

Megjithatë, për çdo gjë më vini në dijeni, formuloni gjithçka që të jemi korrekt për mënyrën se si duhet të procedojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë e kemi biseduar, tani jemi te rekomandimet që duhet t'i bëjmë ne për vitin që vjen, çfarë duhet të ketë parasysh ERRU-ja, që kur të vijë në fillim të vitit tjetër e të flasë për këto rekomandime, ne të dimë për çfarë t'i kërkojmë llogari. Pra, edhe ta vëmë në pozita pune, edhe t'i kërkojmë llogari kur të vijë të raportojë pas një viti.

Kjo është edhe mënyra sesi është vepruar ndër vite ndaj edhe shumë rekomandime që janë bërë, sot mund të vazhdojnë të jenë shqetësime, por nuk janë më shqetësime primare, nuk futen më në rezolutë, për shembull, çështja e faturimeve afrofe është diskutuar për vite të tëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por borxhin nuk e ka ERRU-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më thoni, çfarë t'i rekomandojmë ERRU-së, që shiko, shtyji ndërmarrjet? Nuk kanë lidhje.

Baftjar Zeqaj – Ju bëtë një sugjerim konkret dhe jo të gjitha vërejtjet apo propozimet nuk janë kompetencë e ERRU-së, por kjo bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe me ministrinë, kështu që le të shihet edhe si një lloj bashkëpunimi. Për shembull, këtu flitet për humbjet dhe për punën jo shumë të mirë që është bërë gjatë vitit 2021 për të sjellë një ndryshim të rrënjësishëm për humbjen dhe unë nuk shoh alternativa konkrete lidhur me këtë çështje. Unë do të sugjeroja ngritjen e strukturave kontrolluese. Eksperiencë shumë të mirë ka pasur për energjinë elektrike, kështu që nuk besoj të jenë humbje shumë të mëdha për energjinë elektrike ose të pakontrolluara, së paku. Pra, le të jetë këtu një task forcë apo një strukturë kontrolluese, që të mos jetë pafund çështja e humbjeve.

Unë sjell ndër mend disa punonjës të thjeshtë të ujësjellësve që kontrollojnë linjat e të tjera, që nuk kanë shumë efektivitet, sepse ata nuk kanë autoritet që të ushtrojnë kontroll dhe të vendosin gjoba, ose së paku, ky është një opinion, për të gjithë ujësjellësit në Shqipëri nuk kemi dëgjuar goditje të forta për humbje të mëdha. Sigurisht, kam bindjen që populli paguan në mënyrë permanente, por humbjet qëndrojnë në vende të spekulatorëve, nuk po flas për biznesin. Pra, ideja ime është që të ngrihen struktura kontrolluese, siç ka sektorët e tjerë, ose siç i ka OSHEE-ja.

Te pika 4 më duket sikur justifikohet puna e dobët e drejtuesve, që thonë fut duart politika. Ata s'e kanë fare të qartë se çfarë është politika, politikë do të thotë në qoftë se komisioni ynë apo Kuvendi ka marrë disa vendime ose akte nënligjore që do të marrim militantë të partisë, atëherë po, do të thotë se po e marrin në qafë, por, në fakt, mund të shkojnë t'i kërkojnë gjithçka dhe një drejtues apo një staf nuk mund të thotë që këtë e paska marrë në qafë politika qoftë për të vendosur njerëz jo fort të kualifikuar, qoftë për të marrë njerëz mbi organikë. Në qoftë se ka një strukturë të qartë dhe në qoftë se ka kritere plotësisht ligjore për një vend pune qoftë edhe për roje, nuk ka pse e merr në qafë politika.

Për pritjen e popullit, nuk ekzistojnë struktura ose ambiente tek ujësjellësit, që njerëzit të bëjnë vërejtje apo sugjerime për faturimet, të paktën. Në Fier, me aq sa di unë, po të kenë ndonjë vërejtje takohen me drejtorin apo zëvendësdrejtorin, kur në fakt duhet të ketë një sallë të hapur, të monitoruar mundësisht për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që kanë njerëzit për faturimet apo për çështje të ndryshme. Pra, në përgjithësi flitet për mangësitë që kanë ujësjellësit në rrjetet sociale, pasi nuk kanë ambiente ta bëjnë një gjë të tillë. Duhet të ketë një ambient, siç kanë bashkitë zyra me një ndalesë, por kjo duhet të jetë e ligjruar. Besoj se vitin tjetër njerëzit që do

të kenë ankesa, do të kenë një ambient ku të priten nga dy juristë, që do t'i shtohen strukturës vetëm për të dëgjuar sugjerimet e njerëzve.

Nuk është fjala që ne t'i votojmë, por krahas rezolutës, që unë bie dakord, mund të bëhen edhe këto sugjerime për ta pasuruar.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Zeqaj, e para, meqenëse ju bëtë një vërejtje konkrete për pikën 4, që është edhe shqetësimi i kolegëve të tjerë, ajo çfarë dua të theksoj te pika 4, është që ERRU-ja në tagrin që i jep baza ligjore me të cilën funksionon, duhet të kontrollojë punonjësit jashtë profilit, ku thuhet: “Në terren të kontrollojë me rigorozitet profilin e punonjësve të ujësjellës-kanalizimeve”. Pastaj të kontrollojë numrin e punonjësve.

Në fund fare, meqenëse ky është një shqetësim i ngritur, le të rrinë larg edhe emërimet politike, por bëhet fjalë që ke marrë një punonjës, i cili ka një shkollim tjetër dhe e përdor për një gjë tjetër. Pra, duke qenë se në përgjithësi numri i punonjësve të ujësjellës-kanalizimeve është i lartë, ERRU-ja na thotë se ka vënë re nga kontrollet e bëra në këto ndërmarrje, që ka punonjës jashtë profilit. Ne do t'ia çojmë këtë si rekomandim që ai ta ketë për detyrë që të vazhdojë t'i monitorojë, se thjesht i monitoron, as nuk i ç'emëron dot, as i heq e as i shton dot. Për sa kohë kemi edhe një debat mes nesh që ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve mund të përdoren edhe politikisht për emërimet politike, ne ia lëmë si rekomandim që ERRU-ja të vazhdojë ta monitorojë këtë çështje. Pastaj ne nuk e themi dot që është 10 apo 100 numri i punonjësve, ajo që është e rëndësishme për ne është numri i punonjësve për 1000 lidhje. Këtu kemi një shqetësim, sepse ky numër rritet në mënyrë artificiale nga rojet e sigurisë. Tani ne do të vazhdojmë t'i ruajmë ujësjellës-kanalizimet me roje private apo do të kalojmë me teknologji? Këtë i sugjerojmë ne ERRU-së dhe ajo vetë sërish nuk u imponohet dot ujësjellës-kanalizimeve, ndërmarrjet janë ato që do të vendosin, por ERRU-ja duke qenë se i monitoron kostot, ka mundësinë që ta ulë këtë numër punonjësish duke kaluar në forma teknologjike apo duke pasur në borderotë e tyre punonjës të profesionit dhe të profilit.

Po duket sikur unë po i kundërshtoj mendimet, në fakt, absolutisht. Kam qenë relator në shumë rezoluta qoftë të ERRU-së, qoftë të ERRE-s dhe në përgjithësi ne u rekomandojmë këtyre institucioneve se çfarë duhet të ketë parasysh vitin që vjen. ERRU-ja pastaj në punën e vet kontrollon këto ndërmarrjet e tjera të ujësjellës-kanalizimeve, por nuk u imponohet dot, thjesht i monitoron në aspekt të kostove që ato kanë. Madje drejtori na tha se edhe në çështjen e

investimeve ata nuk kanë fuqi imponuese, pra është AKUM-i ai që vendos se çfarë investimesh do të bëhen dhe ku do të bëhen. Na kërkohet të ndërmarrim një iniciativë ligjore për të zgjidhur kompetencat midis këtyre dy institucioneve, të cilat përplasen herë pas here me njëra-tjetrën. Mund ta bëjmë ne, mund ta bëjë qeveria, mund të vazhdojmë ta diskutojmë këtë çështje, por këto janë rekomandime të punës që duhet të ketë ERRU-ja për vitin që vjen si pika që duhet t'i ketë parasysh që të vazhdojë të raportojnë edhe Kuvendin për performancën e këtij institucioni në raport me detyrat që i lëmë.

Ndaj, në rast se dëshirojmë që të bëjmë një ndryshim, ju lutem, bëjeni konkrete, përndryshe ne mund të vazhdojmë me diskutime sa të dëshirojmë, por sot jemi në fazën e aprovimit dhe votimit të projektrezolutës, kështu që duhet fjalia konkrete, të hiqet apo të vihet kjo fjali, të shtohet apo hiqet kjo, që ne më pas, nëse jemi dakord, ta aprovojmë, nëse jo, do ta hedhim në votim dhe do të fitojë ajo që merr më shumë vota. Ne jemi të detyruar që të operojmë në këtë sens.

Ismet Beqiraj – Më konkretisht unë propozoj që te pika 4 të mbetet pjesërisht: “Enti Rregullator i Ujit në monitorimet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në terren, të kontrollojë me rigorozitet profilin e punonjësve të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, në mënyrë që të përputhet me pozicionet e tyre të punës”. Kaq. Deri këtu, pjesa tjetër është koment politik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se keni qenë edhe kryetar bashkie, ti specialistin s’do ta shohësh nga tesera!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo se kam qenë edhe unë kryetar bashkie, para teje!

Atëherë unë kam një propozim, hidhe në votë! Unë nuk refuzoj dhe as i dal kundër asnjërit, ju mund të propozoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë propozoj që kjo fjali të korrigjohet.

Fatjon Veizaj - Nisur nga propozimi që bëri zoti Zeqaj, në lidhje me ngritjen e një strukture monitorimi, se problemi kryesor në atë që shohim tek ujësjellës-kanalizime ka të bëjë me menaxhimin e fondeve dhe investimin që ata bëjnë, ka të bëjë me vjedhjen e këtyre investimeve, e thënë shqip.

Në një studim, të paktën në opinionin tim, Shqipëria, me aq lekë sa janë shpenzuar do të kishte tre herë më shumë ujësjellësi e kanalizime. Kështu që, ekzistonte mundësia të bëhet një njësi

monitorimi që do të merret me këtë punë apo jo, që ta shënojmë në rezolutë, këtë e them që të mos merremi duke miratuar rezoluta më kot, nëse do të na sjellin në të njëjtën situatë vitin tjetër.

Në qoftë se kjo njësi, që merret me monitorimin e ujësjellës-kanalizimeve, ekziston mundësia që të bëjë një njësi të tillë, ku të merret edhe me kontrollin dhe eficiencën e investimeve që janë bërë, atëherë mendoj se mund të shtohet kjo punë, sepse problemi kryesor, “thembra e Akilit”, përveç pjesës së punësimeve, nuk e gjykoj pse duhet të hiqet, për sa kohë është një element shumë i thjeshtë për të parë sa punonjës ke pasur para kësaj date dhe më jep një shpjegim të arsyeshëm përse janë marrë këta punonjës. Është e thjeshtë.

Për ta përmbledhur, në qoftë se ekziston mundësia tek Enti Rregullator i Ujit të ketë një njësi apo të ketë atributin, ku të kontrollojë investimet e bëra për ujësjellës-kanalizimet, kjo do të ishte gjë e mirë, sepse unë di të paktën dy raste të miat që janë “tender” a “gol”, domethënë është bërë kanalizimi, i cili nuk ekziston, mund t’ua jap edhe me numër, janë 84 puseta dhe është shpallur tenderi për rikonstrukcion kur ujësjellësi nuk ekziston.

Në qoftë se bën vaki që të mund të bëhet kjo punë, atëherë le ta shtojmë.

Arben Pëllumbi – Kolegë, duhet të kemi parasysh që ERRU-ja ka një organigramë të mirëpërcaktuar. Në qoftë se ju kujtohet ne kemi aprovuar para disa javësh postin e sekretarit të Përgjithshëm, pra ata nuk ndërtojnë dot task forca në këtë mënyrë, por e kanë të përcaktuar 28 vetë, i shtuam edhe 1, u bënë 29 veta që merren me monitorimin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. Besoj se është detyrë e një organi ekzekutiv që të ngrejë task forca. ERRU-ja është ent, nuk mund të ngrejë task forcë, pasi nuk ka tagër që ta bëjë këtë gjë.

Pra, duhet të ndajmë shqetësimet e përditshme që ne kemi në zonat tona me ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve. Enti Rregullator i Ujit është monitorues as shkon imponohet, por kontrollon, sugjeron, mund të gjobisë në varësi të kostove, por sesi performon ndërmarrja, nuk është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe 2 gjëra për çështjet që u ngritën këtu. Në pikën 1 thuhet “grantet apo financimet që jepen për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve duhet të kushtëzohen me arritjen e objektivave të vëna nga ERRU-ja në lidhje me performancën”. Ne kaq mund të sugjerojmë dhe nuk bëjmë dot më shumë.

Edhe në pikën 9, në vijim...

Xhelal Mziu – Sa i takon performancës mund t’ju them diçka. Korça është qyteti që ka ujësjellësin me performancën më të mirë. Me logjikën që ne themi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Jo, 1 minutë. Kryetari i ERRU-së ishte i pranishëm këtu dhe na sqaroi që performanca nuk është një e tërë për të gjithë ndërmarrjet e ujësjellësve, por është veç për çdo ndërmarrje. Pra, performanca në qytetin e Korçës është në raport me investimet dhe treguesit që ka qyteti i Korçës, performanca në ujësjellësin e Dibrës është në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ai ujësjellës, pra nuk mund ta krahasosh me Korçën meqë ka më shumë dhe t’i vësh përballë njëra-tjetrës. ERRU-ja thotë: “Në raport me objektivat e vëna nga ERRU-ja”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

ERRU-ja i studion një më një të gjithë ujësjellës-kanalizimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhelal Mziu – Edhe unë që e kam shtëpinë në mes të Kamzës, më vjen uji 1 orë në ditë. Unë po ju them edhe një herë se ajo që ju thoni nuk nxjerr në pah një ndërmarrje që ka nevojë për mbështetje financiare, por i jep mundësi dikujt që ka performancë...

Në këtë kontekst jo vetëm që nuk u jep prioritet atyre që nuk kanë mundësi ekonomike, por lë për të dëshiruar më pas edhe në aspektin politik, por nuk po merrem me pjesën politike.

Unë merrem me aspektin që duhet të mbështeten bashkitë, të cilat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për ta mbajtur një ujësjellës...

Arben Pëllumbi – Ju lutem, zoti Mziu, duhet ta ndani pjesën e eksperiencës së madhe që keni në drejtim të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizime nga ERRU-ja, sepse ERRU-ja nuk është ndërmarrje e ujësjellës-kanalizimeve. Ne sugjerojmë që ERRU-ja të bëj presion që ata i japin grante për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimit t’i japin në bazë të performancës që ERRU-ja përcakton për çdo ndërmarrje veç e veç, sepse ERRU-ja nuk jep grante.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra. Ne duhet t’i drejtohem institucionit të ERRU-së që të ushtrojë presion në mënyrë që grantet të jepen nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në bazë të objektivave që ke vënë për këto ndërmarrje dhe ERRU-ja i vë veç e veç për secilën ndërmarrje, sepse nuk mund t’i vërë njësoj objektivat si për Korçën ashtu edhe Dibrën, sepse Dibra ka të vetat dhe Korça ka të vetat. ERRU-ja duhet të ushtrojë presionin e vet për aq sa i lejohet që grantet të ndahen në

bazë të treguesve të performancës që vetë ERRU-ja ka përcaktuar për këta ujësjellës. Kjo duhet të merret parasysh dhe të luftohet për këtë gjë. Në këtë sens është fjalia që kemi vënë.

Fjalën e ka zoti Nasufi.

Lefter Gështenja – Për procedurë, zoti kryetar.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Ju kërkoj ndjesë zoti Nasufi!

Zoti kryetar, në këtë komision kemi vënë një rregull, të paktën deri tani është respektuar, që flet një nga njëra anë dhe një nga ana tjetër. E kam kërkuar disa herë fjalën dhe nuk e di pse nuk ma keni dhënë. Po ia lë radhën zotit Nasufi, për respekt, por nuk është normale të flasim të gjithë vetëm nga njëra anë dhe më pas të flasim ne.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Mziu nuk e mori fjalën, diskutoi me ju, por pa mikrofon.

Baftjar Zeqaj – Jemi 80% me 20% nga monitorimi që është bërë për kokë, do ta keni në mbledhjen tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Nuk do t'ju marr shumë kohë kolegë, por dua të bëj një koment.

Së pari, për dokumentin parlamentar që formulohet dhe që quhet rezolutë.

Së dyti, për tagrin se kujt i drejtohet si institucion, në këtë rast është Enti Rregullator i Ujit. Kryetari në këtë kuptim ka ndërhyrë disa herë për të qëndruar brenda këtij formati.

Për mendimin tim, po të nisemi nga problematikat që kanë të bëjnë me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve, ne duhet të kemi këtu ministren përgjegjëse që mbulon sektorin e ujit dhe për të dalë më pas tek ato problematikat që i ngritët ju. Ne jemi këtu në formatin e një dokumenti parlamentar, i cili për mendimin tim ka evoluim në 2-3 elemente bazë që nuk kanë qenë në rezolutën e mëparshme dhe që kanë të bëjnë me normimin e fuqisë punëtore, çmontimin e vendeve të punës që kanë qenë qoka, ne të mos bëjmë sikur si dimë nga të tërë krahët politikë, mbingarkesa pa eficiencë që ka bëjë me mbulimin e territorit, menaxhimin e borxhit dhe me ato politika që realizon Enti Rregullator i Ujit. Këto janë pjesë që janë pasqyruar në këtë projektrezolutë.

Po të vijmë te shqetësimet praktike pastaj, ne nuk dalim këtu te përvojat që ndeshen në terren. Ku kemi probleme? Ne kemi probleme me borxhin që kanë ndërmarrjet ndaj ujësjellësve,

me borxhet e klientëve familjarë, të cilët operojnë me kontrata dhe shlyerje të pjesshme, faturimin e ujit, familjet që kanë ikur dhe që banojnë jashtë shtetit, të cilëve u shkon fatura e mbartura, ndërkohë që ata thonë që nuk kanë asnjë lloj shërbimi dhe si ka mundësi që më vjen fatura e të tjera. Në këtë aspekt problemet që ngrihen kanë të bëjnë me strukturat ekzekutive, kurse parashtrimet që bëhen në rezolutë kanë të bëjnë me një institucion që është nomenklaturë e parlamentit.

Pra, duke bërë këto rregullime të vogla mendoj ta kalojmë për votim projektrezolutën.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjalën e ka zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, kryetar!

Së pari, do të doja të dija nga kush është hartuar kjo rezolutë? A është hartuar nga ne, pra nga ky komision apo nga relatori?

Arben Pëllumbi - Është hartuar nga relatori në bashkëpunim me stafin monitorues të shërbimeve të Kuvendit.

Lefter Gështenja – E vlerësoj për punën.

Së dyti, dua të di, sepse në ligj, sipas meje, nuk thuhet që ky institucion, ERRU-ja është edhe institucion mbikëqyrës në sektorin e furnizimit me ujë, por nëse është kështu kërkoj ndjesë, është institucion i pavarur publik përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë. Nëse është edhe mbikëqyrës, por nëse është përgjegjës për monitorimin është tjetër gjë, vijmë te pjesa që ai duhet të jetë përgjegjës për të gjithë veprimtarinë që kanë institucionet e varësisë, pra drejtoritë e ujësjellës-kanalizimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne themi: “Kuvendi i Shqipërisë vlerëson për vitin 2021”, po i referohem rezolutës, po bëj thjesht një korrigjim ortografik, por duhet të më korrigjoni ju “përmirësim i lehtë” besoj se duhet të jetë “përmirësimin e lehtë të të gjithë treguesve”.

Ndërkohë, besoj se të gjithë biem dakord, nga raporti që kemi parë, edhe nga ajo çka relatoi titullari i këtij institucioni, se treguesit nuk janë të përmirësuar, por janë përkeqësuar. Pra, nga e gjithë ajo çfarë pamë, si cilësia e shërbimit, humbjet në rrjet, kostot e OM-së e të tjera që janë rritur, pra të gjitha këto janë përkeqësuar, përfshirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të doni i marrim një nga një, sepse unë kam parë edhe raportin me shumë vëmendje. Unë po ju them që nuk ka tregues të përmirësuar. A mund të më thoni një tregues? Cila, cilësia e ujit në Tiranë? Sa paguhet uji në Tiranë dhe çfarë cilësie ka? Paguhet si ujë i pijshëm, ndërkohë që nuk bën as për të larë dyshehenë. Nëse dikush prej nesh thotë që ai ujë pihet, atëherë unë kërkoj falje dhe them që ka të drejtë. Këtu nuk mund të flasim për tregues cilësie që janë përmirësuar.

Sa i takon pikës 1, ju me të drejtë, të dashur kolegë, do të doni ta hidhni në votim dhe me shumicë votash e fitoni ju, por kjo nuk është e vërtetë, sepse është faktuar si në raportin e paraqitur, edhe me faktet reale që janë kështu siç po themi ne.

Sa i takon pikës 2, është në rregull nuk kam vërejtje.

Pika 3, është në rregull.

Pika 4, ne, pra Kuvendi i Shqipërisë, vlerësojmë punën e bërë nga ERRU-ja për zgjidhjen e problematikave në drejtim të faturimit të konsumatorëve familjarë kur ata nuk janë të pajisur me matës, të cilët faturohen me 150 litra në ditë për person apo 4,5 metra kub në muaj për person. Sa i takon kësaj, nuk e di se çfarë vlerësim duhet të shprehim, por, gjithsesi, për mua edhe kjo nuk ka vend.

Pika 5, është në rregull.

E fundit, studimi i bërë nga ERRU-ja lidhur me problematikën e mbulimit të kostos së energjisë, ne vlerësojmë studimin e bërë nga ERRU-ja, apo jam gabim, për një problem të madh, një gangrenë që kanë ujësjellësit. Kjo nuk duhet të ekzistonte dhe nuk e kuptoj pse ne duhet ta vlerësojmë ne këtë, një studim që ata paskan bërë?

Kjo është e tepërt.

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja, duhet të kini parasysh që vlerësimet që ne bëjmë i bëjmë në varësi të detyrave që u kemi lënë në rezolutën e vitit të kaluar. Në qoftë se në rezolutën e vitit të kaluar ne u kemi thënë: “Sugjerojmë që ju të bëni një studim për këtë gjë”, studimi është bërë, sepse për pikat që u kemi lënë si detyrë duhet të themi se çfarë mendojmë dhe se çfarë detyrash do të kenë për vitin që vjen.

Lefter Gështenja – Dakord, zoti kryetar!

Ne nuk kemi thënë që e vlerësojmë si detyrë e mbartur. Gjithsesi, e pranoj kështu siç ju e thoni, por ne si deputetë, si përfaqësues të Kuvendit nuk mund të vlerësojmë diçka që e ka pasur për detyrë një institucion, siç është ERRU-ja. Megjithatë për mendimin tim kjo pikë nuk duhet të

përfshihet, por nëse ne na duhen disa pika, se nuk kemi me çfarë ta mbushim materialin për ta quajtur projektrezolutë, jam dakord, do të hesht dhe nuk do të vazhdoj më.

Ne po japim rekomandime për vitin 2022. ERRU-ja në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe me aktorë të tjerë duhet të bashkërendojë punën për të gjetur zgjidhjet konkrete dhe mekanizmat e duhur për të vënë në pozita pune ndërmarrjet për përmirësimin e performancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grantet apo financimet, siç e tha edhe zoti Mziu, duhet të kushtëzohen nga objektivat dhe performanca, ndërsa unë them jo, sepse nuk mund t'jua kushtëzosh. Po ata që nuk kanë, pra ato drejtori apo ujësjellës-kanalizime nuk do të përmirësohen asnjëherë?

Arben Pëllumbi – ERRU-ja nuk jep grante, por ERRU-ja duhet të imponohet te strukturat që japin grante në mënyrë që ato grante të shpërndahen në varësi të realizimit të performancës që ERRU-ja ka bërë për ndërmarrjet që njihen si të specializuara.

Lefter Gështenja – I nderuar zoti kryetar, më falni sa ta mbaroj se nuk do ta vazhdoj gjatë!

Pika 3, e kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, po e them edhe tani, jemi kolegë dhe mua më pëlqen shumë kur jemi të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin, ka diçka që fshihet në këtë histori, reforma. Nga të gjitha informacionet që kam, është duke u bërë dhe është në projekt një reformë për sektorin e ujit, po e deklaroj prapë, ku kërkohet një ndiqet një model, i cili është një model i dështuar, ashtu siç është sot OSHEE-ja. Përfshihen pushteti vendor dhe bashkitë, edhe pse sot janë nën drejtimin e drejtuesve dhe përfaqësuesve tuaj politikë, pra të maxhorancës, në 99,9% të rasteve, ndërkohë që ata duhet të jenë pjesë e kësaj strategjie. Sipas meje, qofsha i gabuar, duhet të jenë aksionerë të ujësjellës-kanalizimet, prandaj gjykoj që kjo është diçka e fshehur.

Ne duhet t'i rekomandojmë ERRU-së të përfshihet në këtë pjesë, duke dhënë kontributin e vet dhe të bashkëpunojë me ministrinë, AKUM-in e të tjera për strategjinë e reformës, por nëse ka si qëllim që të kemi një OSHEE të dytë, mendoj se duhet të hiqet nga ky projektrezolutë.

Lidhur me pikën 4, të cilën e kishte merak zoti Beqiraj, mendoj se nuk duhet të ndryshohet, sepse më mirë sesa e ka studiuar dhe parë institucioni i ERRU-së këtë gjë, nuk e dimë ne. Në të thuhet “shumë mirë që politikat duhet të nxjerrë duart dhe të distancohet nga ujësjellësit nga të gjitha anët”, prandaj mendoj se pika 4 nuk duhet të ndryshohet.

Këto kisha sa i takon kësaj projektrezolute.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Gështenja!

Kam një sqarim të vogël. Qeveria nuk e ka fshehur që ka një ambicie për të sjellë një ndryshim në çështjen e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve, por e ka bërë publike këtë gjë. Agregimi, ekonomia e shkallës, ndoshta edhe ndryshimi i pronësisë së ujësjellës-kanalizimeve mund të shihen, por në rast se kjo do të ndodhë, ne i sugjerojmë ERRU-së që të jetë pjesë e këtij diskutimi. Në rast se qeveria do të ecë me këtë projekt të vetin në lidhje me mënyrën se si do të agregohet dhe se si do të jetë çështja e pronësisë, nëse do ta bëj ligj dhe do të vij në parlament, është diçka tjetër, por nëse do të ketë apo ka një proces të tillë, ERRU-ja duhet të jetë pjesë e tij dhe të mos rrijë mënjanë. Kjo është ajo që ne sugjerojmë, duke marrë pjesë dhe duke thënë fjalën e saj si një ent që ka një eksperiencë të caktuar në këtë fushë. ERRU-ja nuk i imponohet dot qeverisë që ta bëj kështu apo ashtu, por i takon. Pra, sugjerimi që ne vazhdojmë t'i bëjmë është që të vazhdoj të jetë prezente në diskutimet që bëhen për të ardhmen e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Lefter Gështenja – A mund të shtohet, meqë jemi këtu, “edhe njësitë vendore?”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë pronarë, por ndërkohë ne themi të bashkërendojë punën me ministrinë, me këtë dhe atë, por nuk themi gjë për ata që janë pronarë.

Arben Pëllumbi – Ata e marrin iniciativën për ta bërë këtë çështje nuk e marrin bashkitë.

Lefter Gështenja – Ndoshta me letra ata po e marrin.

Kush e merr iniciativën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pika 3.

Autoritetin pronar e përjashton, nuk e ke këtu, i cili duhet të bashkërendojë...

ERRU-ja duhet të bashkërendojë punën, duhet të bashkëpunojë edhe me pronarin. Ne themi të bashkëpunojë me këta të tjerët dhe me qeverinë, ndërsa me pronarin jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, e kam parë, sepse të garantoj që lexoj shumë mirë si natën, ashtu edhe ditën.

Kaq është e vështirë të thuhet se kush janë aktorët e tjerë?

Ta themi që është pushteti vendor, sepse nuk ka asnjë gjë të keqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Laert Duraj – Zoti Gështenja, në cilësinë e relatorit më duhet t'ju them se si aktorë kryesorë të sektorit të ujit nënkuptoj bashkitë, pushtetin lokal, por nëse dëshironi që të jetë më e qartë në të shprehur, atëherë patjetër të shtohet “bashkitë dhe aktorët të tjerë kryesorë”, që mund të jenë edhe ente të ndryshme, pra të mos kufizohemi vetëm te bashkia.

Personalisht, si relator jam dakord.

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja propozon që pika 3 të riformulohet: “ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKUM-in, AMPUN-në, pushtetin lokal, si dhe aktorë të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për të bërë të mundur përmirësimin”. Të shtohet ky togfjalësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Nuk ka kaluar për votim?

Arben Pëllumbi – Jo, unë vetëm e formulova.

Xhemal Mziu – Kjo projektrezolutë shihet që është një iniciativë që vjen nga lart dhe aktualisht ministria sot për sot nuk ka asnjë lidhje me ujësjellësit, por janë 100% në varësi të pushtetit vendor, aksioner 100% është bashkia.

Për këtë rezolutë vota ime është kundër. Po ju jap 3 gjëra për ta kuptuar më mirë. Është bërë analizimi i arsimit dhe nuk ka më drejtori arsimorë as në Dibër, po marr si shembull Dibrën meqë jam andej, si rreth dhe si qark, sepse Drejtoria Rajonale është në Durrës dhe një mësues duhet të shkojë në Durrës.

Po marr një tjetër Drejtori Rajonale, që është absolutisht skandaloze, ku për mirëmbajtjen e rrugëve në qarkun e Dibrës, e ka qendrën në Shkodër. Drejtoria e Bonifikimit apo e Pyjeve është në Tiranë. A e kuptoni sa skandaloz është ky fakt? Rajonalizimi dhe futja e ministrisë është hileqare, pasi kjo është një iniciativë që nuk vjen nga poshtë, por nga sipër, prandaj jam kundër futjes së ministrisë për të bërë rajonalizimin.

E thashë edhe pak më parë në fjalën time që, për rajonalizimin dhe ekonominë e shkallës, duhet të plotësosh kushtet ekstensive, që të ketë të paktën ujë dhe më pas të vazhdojmë me pjesën intensive apo për të krijuar standarde. Ne kemi një bashki që furnizohet me ujë 24 orë, kemi dhe një bashki që nuk ka as gjysmë ore ujë.

Arben Pëllumbi – Të mos i kthehemi prapë nga e para.

Pika 3, ashtu sikurse e ndryshuam, ka të bëjë me kontributin që duhet të japë ERRU-ja në lidhje me strategjinë, të cilën nuk e ndërtojnë vetë ujësjellësit, por e ndërton ministria në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, dhe ERRU-ja të jetë pjesë e këtyre diskutimeve. Këtë sugjerojmë ne. Sugjerojmë të jenë edhe bashkitë. Sigurisht, strategjinë ministria do ta bëjë, se nuk e bëjnë ujësjellësit. Ne këtu flasim për strategjinë. Pastaj se cila do të jetë strategjia, se sa dakord mund të jemi me atë strategji, se sa kundër mund të jeni ju si opozitë, kjo është tjetër gjë. Ajo do të vijë dhe do të diskutohet si strategji, por ne këtu ERRU-së i themi: “Kur të diskutohet për strategjinë, ti të jesh pjesë e saj”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për strategjinë e menaxhimit të sektorit të ujit.

Sido që të jetë, e dinë ata që drejtojnë këtë vend, të cilëve u është besuar kjo punë. Kaq. Nuk do ta diskutojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Kryetar, flasim për strategjinë e reformës, jo për strategjinë... Jam absolutisht dakord që, nëse do të kemi strategji kombëtare për ujësjellës-kanalizimet, e cila tashmë është e miratuar, le të jenë të gjithë aktorët që ne citojmë këtu, përfshirë edhe bashkinë, por ne këtu po flasim për një strategji tjetër, për strategjinë e reformës së ujit, e cila kërkohet të centralizohet në nivel qarku. Këtë po them, që duhet të jemi më transparentë me njëri-tjetrin, më të hapur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, i dashur kryetar! Çfarë po bëjmë ne më këtë projektrezolutë? Ne po i ngremë topin ministrisë dhe po i themi: “Ne e ngritëm, gjuaje tani. Do ta gjuash apo nuk do ta gjuash?” “Po, do ta gjuaj”, do të thotë ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, a mund ta bëjmë ndryshe? Ta heqim fare pikën 3, se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhelal Mziu - Qeveria le ta bëjë, le ta marrë iniciativën...

Lefter Gështenja – Le ta bëjë, jo “i rekomandojmë ne”.

Xhelal Mziu – Ne po bëhemi zëri i qeverisë dhe po i themi që bëje këtë veprim.

Lefter Gështenja – Janë të përcaktuara detyrat, kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhelal Mziu – Qeveria nesër mund të thotë që të gjithë ujësjellësit do t'i privatizojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arbën Pëllumbi – Ne nuk po i rekomandojmë qeverisë dhe as nuk po i tregojmë se çfarë të bëjë, por po i themi që ERRU-ja të bashkëpunojë me këta aktorë për strategjinë e reformës në sektor. Është deklaruar që ka një strategji të reformës dhe ERRU-ja nuk duhet të rrijë jashtë këtyre diskutimeve, por duhet të marrë pjesë. Ne këtë po themi. Leva ose mekanizmi i vetëm që ne, si Kuvend i Shqipërisë, kemi në raport me reformën është ERRU-ja, që është i vetmi ent që varet nga ne. Tani, ta përjashtojmë edhe këtë ent që aty? Le të jetë enti! Le të marrë pjesë në diskutime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Laert Duraj – Konkretisht, në dëgjesën që bëmë dhe me drejtuesit e ERRU-së, ju personalisht vlerësuat shumë kontributin e një zotërie, të cilit nuk ia kujtoj emrin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të drejtorit, i cili ishte vërtet specialist i mirë. Madje, dhe nga të tjerët u dhanë goxha shembuj të mirë, le të themi, në vendet fqinje dhe më gjerë se si menaxhohej sektori i ujit. Kështu që e gjithë kjo eksperiencë që kanë ata zotërinjtë, qoftë dhe informacionet që kanë me çfarë ndodh përreth, e mira është t'i bashkëngjiten kësaj reforme. Fundja edhe pa rekomandimet tona, ata e kanë detyrë funksionale të japin opinionin e tyre.

Unë e quaj me shumë vend, edhe me ndryshimin e zotit Gështenja, rekomandimin që ERRU-ja të jetë pjesë përbërëse seriozisht e reformës, që të japë kontributin e saj qoftë me këshilla e sugjerime, qoftë edhe me qëndrime të prera, le të themi, kur mendon se diçka nuk shkon, siç janë praktikat më të mira. Pse të mos jetë? Unë e gjykoj me shumë vend.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Kolegë, ky është një sektor, ashtu si sektori i energjisë, që na afekton të gjithëve dhe ne nuk do t'i mbaronim kurrë diskutimet për këtë çështje. Shqetësimet vazhdojnë të jenë. Sado të ecet, këta dy sektorë janë gjithmonë elemente të jetës së përditshme të qytetarëve që ne përfaqësojmë, që afektojnë përditshmërinë e tyre. Ne gjithmonë kemi problematika për të trajtuar e diskutuar. Përpara kemi një rezolutë, të cilën na duhet ta aprovojmë dhe ta kalojmë.

Kështu që duhet të hedh në votim propozimin e bërë nga zoti Gështenja për pikën 3 të rekomandimit për vitin 2022, me ndryshimin që lexova më parë. Kush është dakord me këtë ndryshim? Pra, pika 3 ndryshon sipas tekstit që lexova qëparë, pra shtohet edhe pushteti lokal.

Kemi dhe një propozim nga zoti Beqiraj për ndryshimin e pikës 4, e cila duhet të përfundojë: "...që të përputhet me pozicionin e tyre të punës" dhe të heqim pjesën tjetër të fjalisë, e cila ka të bëjë me konotacione politike. Kush është dakord me këtë propozim? Janë 7 vota pro. Kundër? 4 vota. Abstenime nuk ka.

Miratohet ndryshimi i zotit Beqiraj. Edhe pika 4 ndryshon.

Ju lutem, mbajeni shënim!

Kush është dakord me projektrezolutën "Për veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit për vitin 2021"? Janë 7 vota pro. Kundër? 4 vota. Abstenime nuk ka.

Miratohet projektrezoluta, që tani bëhet rezolutë për Entin Rregullator të Ujit.

Faleminderit të gjithë kolegëve për kontributin që dhanë në këtë rezolutë!

MBYLLET MBLEDHJA